




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRISTINA



PSH.nr.1122/20  
1065/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Quality Asphalt” SH.P.K-Ferizaj, si dhe OE “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Kema-Company” SH.P.K.; “Pro & Co Group” SH.P.K-Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1, me nr. të prok: 616-20-2390-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, më datën: 25.01.2021, mori këtë:

## V E N D I M

I. **APROVOHEN**, pjesërisht si te bazuara ankesat e operatorit ekonomik “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik, dhe ankesa e operatorit ekonomik “Quality Asphalt” SH.P.K-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1 , me nr. të prok: 616-20-2390-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1 , me nr. të prok: 616-20-2390-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Quality Asphalt” SH.P.K-Ferizaj, dhe ankesa e OE “Sallahu” SH.P.K. – Kaçanik, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Quality Asphalt” SH.P.K-Ferizaj dhe OE “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 21.12.2020 me nr. 1122/20, dhe me 28.12.2020 me nr. 1165/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1, me nr. të prok: 616-20-2390-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, 69, 61, 72, 11 dhe nenin 108/A të LPP-së, si dhe nenin 39.8 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 1122/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 28, 51, 52, 56, 59, 60, 69, 72 dhe nenin 108/A të LPP-së, te ankesa me nr. 1165/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirm nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:



## **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Quality Asphalt” SH.P.K-Ferizaj 1122/20**

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtine, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës në lotin 1 pas ri vlerësimit të ofertave.

### **Përgjigje në pretendimin ankimore (neni 113):**

Fillimisht po sqarojmë se loti 1 i këtij aktiviteti të prokurimit ka qene objekt shqyrtimin në OSHP, rrjedhimisht disa nga pretendimet ankimore tani me i kemi trajtuar, po ashtu edhe paneli shqyrtues përmes vendimit me nr. 858/20, të datës 16.11.2020, kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar aneksen e OE “Sallahu” shpk – Prishtine, ku përmes arsyetimit të njëjtit vendim është obliguar AK – Komuna Prishtine, që të kërkohej sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72, të LPP-se. Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt stafit dhe përvojës së tyre, AK – Komuna Prishtine përmes procesit të rivlerësimit, me datën 03.12.2020, ka kërkuar sqarime shtese nga operatori ekonomik edhe tani i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar përgjigje, të cilat e kanë bindur AK-ne. Pretendimi tjetër lidhur me licencën e kompanisë e cila ka vlerësuar riskun, sqarojmë se AK, përmes dëshmisë dokumentare të pozicionit nr. 3, të përshtatshmërisë profesionale, nuk ka kërkuar nga OE-te të prezantojnë licence si dëshmi. Është kërkuar të dëshmohet raporti i vlerësimit të riskut për të gjitha pozitat e organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga MPMS. OE i rekomanduar ka, prezantuar raportin i cili është vëlosur nga kompania B&M sh.p.k- Ferizaj, rrjedhimisht AK, e ka trajtuar si kompani të licencuar. Pretendimi tjetër ankimore që ka të bëjë me çmimet jo normale, kontestohen pozicionet 3.1 dhe 3.2, të OE të rekomanduar për dhënie. Sipas nenit 61, të LPP-se, përgjegjësia e çmimeve jo normale bie mbi AK-ne, rrjedhimisht nëse duken apo ekzistojnë çmime jo normalisht të ulëta AK, kërkon sqarim nga ofertues. Përfundimisht sipas asaj që u përshkrua si më lart, përkatësisht sipas dispozitave të nenit 108/A, operatori ekonomik ankues nuk i ka aplikuar procedurën e ankimimit komform dispozitave ligjore. Paragrafi 3.2, i të njëjtit nen qartë sqaron rastet e kontestimit apo ankimimit të njoftimit për dhënie të kontratës **“në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit”**. Si prova shkresore se bashku me raport gjeni kopjet: Kërkesa për sqarim; Përgjigjen kundrejt kërkesës; Pjesë nga raporti i vlerësimit të riskut.

### **Mendimi i ekspertit shqyrtues**

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, vendimit paraprak të PSH-së dhe procedurës së prokurimit, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hudhet si e pa lejuar.

### **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Sallahu”SH.P.K-Kaçanik, (1165/20)**

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtine, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës në lotin 1 pas ri vlerësimit të ofertave.

### **Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113):**

Fillimisht po sqarojmë se loti 1 i këtij aktiviteti të prokurimit ka qene objekt shqyrtimin në OSHP, rrjedhimisht disa nga pretendimet ankimore tani me i kemi trajtuar, po ashtu edhe paneli shqyrtues përmes vendimit me nr. 858/20, të datës 16.11.2020, kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar aneksen e OE “Sallahu”shpk – Prishtine, ku përmes arsyetimit të njëjtit vendim është obliguar AK – Komuna Prishtine, që të kërkohej sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72, të LPP-se. Edhe tani i njëjti OE e konteston ri vlerësimin e ofertave. Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt stafit dhe përvojës së tyre, AK – Komuna Prishtine përmes procesit të rivlerësimit, me datën 03.12.2020, ka kërkuar sqarime shtese nga operatori ekonomik edhe tani i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar përgjigje, të cilat e kanë bindur AK-ne, edhe pse në përmes raportit paraprak kemi sqaruar se përvoja e punës është aplikuar me variante 5 dhe 3 vite përvojë pune. Sipas dispozitave të LPP-se është e ndaluar aplikimi i varianteve tek kërkesat e kualifikimit. AK, sqarimet i ka kërkuar përmes platformës, përderisa përgjigjet i ka pranuar përmes e-mailit. Po ashtu edhe pretendimet tjera kundrejt pajisjeve në përmes raportit paraprak kemi sqaruar se OE edhe tani i rekomanduar për dhënie të kontratës në lot 1, përveç pasjeve tjera në oferte ka prezantuar edhe pajisje në emër të OE “Ekskavatori” të cilit kontrata i është dhënie në lotin 4. (Për të gjitha lotët janë kërkuar pajisje teknike) Për këtë pike AK përmes procesit të ri vlerësimit nuk ka kërkuar sqarim shtese, përkatësisht vetëm për “cisternën e ujit”. Se bashku me ankese parashtruesi i ankesës ka prezantuar listën e pajisjeve si dhe marrëveshjen e datës 13.07.2020, të lidhur nga “Eskavatori”sh.p.k dhe “Kema Company”. Po ashtu parashtruesi i ankesës se bashku me ankese ka prezantuar edhe dëshmitë e prezantuara kundrejt stafit profesional të prezantuar nga OE i rekomanduar për dhënie në lotin 1, pas kërkesës për sqarim të AK-se, prova të cilat i ka bashkëngjisim këtij raportit. Përderisa lidhur mos identifikimin financiar nuk e bene një oferte të pa përgjegjshme. Po ashtu edhe pretendimi tjetër lidhur me atë se paramasa është e pa plotësuar, sqarojmë se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie në lot 1, i ka ngarkuar dy paramasa për të njëjtin lot, pozicionet e të cilave janë të plotësuara. Parashtruesi i ankesës ka ngritur edhe pretendime tjera procedurale ku potencohet se AK, në njoftimin mbi vendimin e AK-se të datës, 10.12.2020, i ka renditur si OE të përgjegjshëm të gjithë pjesëmarrësit e lotit 1, përderisa përmes raportit të ri vlerësimit disa nga ta janë të eliminuar.



Përfundimisht sipas asaj që u përshkrua si më lartë, përsëri propozimi ynë për AK, është që lënda të kthehet në ri-vlerësim, me qëllim që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave, përkatësisht të vet vlerësohet nëse me variante të kërkesave të kualifikimit mund të kemi vlerësim real, bazuar në dispozitat ligjore për prokurim publik në përgjithësi dhe në veçanti nën 59. Si prova se bashku me raportin gjenerojmë kopjet e listës së pajisjeve, marrëveshja për marrjen me qera të pajisjeve, paramasa e OE të rekomanduar në lot 1 dhe kërkesën për sqarim të shpeshtë kundrejt të njëjtit OE.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht a bazuar, të anulohet propozimi për dhënie në lot 1, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë 13.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 13.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Sallahu" SH.P.K-Kaçanik me datë 15.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar,

Me datë 13.01.2021 kemi pranuar Raportin e ekspertit shqyrtues të prokurimit, lidhur me Ankesën nr 1165/20 të datës 28.12.2020, për aktivitetin e prokurimit; "Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse" me nr. të prokurimit 616-20-2390-5-1-1 (Lot 1) të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Prishtinë, ndaj të cilëve kemi parashtruar ankesë sipas dispozitave ligjore, dhe bazuar në kërkesën nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për përgjigje lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, Kompania Sallahu Sh.p.k deklaron: Qëndrojmë pranë të gjitha pikave të Ankesës me nr. 1165/20 të datës 28.12.2020 dhe pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, dhe të anulohet propozimi për dhënie të kontratës për LOT 1, duke pasur parasysh që edhe eksperti ka konstatuar shkeljet dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave në përputhje me nën 59 të LPP-së.

Nuk pajtohemi që në gjetjet e ekspertizës nuk janë trajtuar të gjitha pikat ankimore, sepse në ankesën me nr. 1165/20 ne kemi parashtruar numër të madh të shkeljeve të argumentuara me prova lidhur me

parregullsitë që e kanë përshkruar procesin e vlerësimit të ofertave dhe rekomandimin e komisionit për shpërblim me kontratë. Andaj bazuar në ankesën tonë dhe në raportin me konstatimet e ekspertit shqyrtues, kërkojmë nga paneli shqyrtues që ta aprovoj si të bazuar ankesën tonë dhe në përputhje edhe me rekomandimin e ekspertit ta kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim për LOT 1, duke u bazuar në shkeljet të LPP-së dhe RRUOPP të cilat i ka bërë AK KK Prishtinë me rastin e vlerësimit të ofertave dhe rekomandimit të OE fitues. Me respekt.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues "Quality Asphalt" SH.P.K-Ferizaj, kundrejt stafit dhe përvojës së tyre, AK – Komuna Prishtinë përmes procesit të rivlerësimit, me datën 03.12.2020 ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik, kurse OE tani i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar përgjigje të cilat e kanë bindur AK-në. Pretendimi tjetër lidhur me licencën e kompanisë e cila ka vlerësuar riskun, sqarojmë se AK, përmes dëshmisë dokumentare të pozicionit nr. 3, të përshtatshmërisë profesionale nuk ka kërkuar nga OE-të të prezantojnë licencë si dëshmi. Është kërkuar të dëshmohet raporti i vlerësimit të riskut për të gjitha pozitat e organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga MPMS. OE i rekomanduar ka prezantuar raportin i cili është vulosur nga kompania B&M sh.p.k- Ferizaj. Rrjedhimisht AK e ka trajtuar si kompani të licencuar.

Pretendimi tjetër ankimor që ka të bëjë me çmimet jo normale, kontestohen pozicionet 3.1 dhe 3.2 të OE të rekomanduar për dhënie. Sipas nenit 61 të LPP-së, përgjegjësia e çmimeve jo normalisht të ulëta bie mbi AK-në, rrjedhimisht nëse duken apo ekzistojnë çmime jo normalisht të ulëta AK, kërkon sqarim nga ofertues. Përfundimisht sipas asaj që u përshkrua si më lartë, përkatësisht sipas dispozitave të nenit 108/A, operatori ekonomik ankues nuk i ka aplikuar procedurën e ankimit komfor dispozitave ligjore. Paragrafi 3.2 i të njëjtit nen qartë sqaron rastet e

kontestimit apo ankimit të njoftimit për dhënie të kontratës "në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda



afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit”.

Lidhur me pretendimet e OE ankues “Sallahu”SH.P.K-Kaçanik, Paneli Shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit për Lot 1 ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP, ku Paneli Shqyrtues përmes vendimit me PSH.nr.858/20 të datës 16.11.2020 kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar aneksen e OE “Sallahu” shpk – Prishtine, ku përmes arsyetimit të njëjtit vendim është obliguar AK që të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Edhe tani, i njëjti OE e konteston ri vlerësimin e ofertave. Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt stafit dhe përvojës së tyre, AK – Komuna Prishtine përmes procesit të rivlerësimit, me datën 03.12.2020 ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik edhe tani i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar përgjigje, të cilat e kanë bindur AK-në, edhe pse më herët është sqaruar se përvoja e punës është aplikuar me variante 5 dhe 3 vite përvojë pune. Sipas dispozitave të LPP-së është e ndaluar aplikimi i varianteve tek kërkesat e kualifikimit. AK sqarimet i ka kërkuar përmes platformës përderisa përgjigjet i ka pranuar përmes e-mailit. Po ashtu, edhe pretendimet tjera kundrejt pajisjeve, është sqaruar se OE edhe tani i rekomanduar për dhënie të kontratës në lot 1, përveç pasjeve tjera në ofertë ka prezantuar edhe pajisje në emër të OE “Ekskavatori” të cilit kontrata i është dhënë në lotin 4. (Për të gjitha lotët janë kërkuar pajisje teknike). Për këtë pikë, AK përmes procesit të ri vlerësimit nuk ka kërkuar sqarim shtesë, përkatësisht vetëm për “cisternën e ujit”. Së bashku me ankesë, parashtruesi i ankesës ka prezantuar listën e pajisjeve, si dhe marrëveshjen e datës 13.07.2020 të lidhur nga “Eskavatori” sh.p.k dhe “Kema Company”. Po ashtu, parashtruesi i ankesës së bashku me ankesë ka prezantuar edhe dëshmitë e prezantuara kundrejt stafit profesional të prezantuar nga OE i rekomanduar për dhënie në lotin 1, pas kërkesës për sqarim të AK-së. Lidhur me mos identifikimin financiar nuk e bënë një ofertë të pa përgjegjshme. Po ashtu, edhe pretendimi tjetër lidhur me atë se para masa është e pa plotësuar, sqarojmë se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie në lot 1, i ka ngarkuar dy paramasa për të njëjtin lot, pozicionet e të cilave janë të plotësuara. Parashtruesi i ankesës ka ngritur edhe pretendime tjera procedurale ku potencohet se AK në njoftimin mbi vendimin e AK-se të datës 10.12.2020, i ka renditur si OE të përgjegjshëm të gjithë pjesëmarrësit e lotit 1, përderisa përmes raportit të ri vlerësimit disa nga ta janë të eliminuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se OE ankues “Quality Asphalt” Sh.p.k.-Ferizaj nuk e ka aplikuar procedurën e ankimit konform dispozitave ligjore, ku është përcaktuar se nëse shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie


të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit. Kurse, sa i përket pretendimeve të OE ankues “Sallahu”, Paneli Shqyrtues konsideron se AK nuk ka bërë vlerësim të drejt të ofertave kundrejt kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit dhe nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Andaj, obligohet AK që me rastin e rivlerësimit të ketë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe të veproj në harmoni me nenin 59 të LPP-së me qëllim që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave, përkatësisht të vetë vlerësohet nëse me variante të kërkesave të kualifikimit mund të kemi vlerësim real.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesori i Panelit Shqyrtues  
  
Blerim DINA

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK “KK-Prishtinë”;
- 1x1 OE “Quality Asphalt” SH.P.K-Ferizaj;
- 1x1 OE “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.